



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 02.06.2022

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 29.05.2022 të parashtruar nga OE "As tech" SHPK, - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi dhe mirëmbajtja e klimave ne objektin e komunës dhe institucioneve tjera Komunale", me Nr. të Prok: 616-22-1994-1-2-1 dhe numër te brendshëm 616 22 019 121 nxjerr:

VENDIM

Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e OE "As tech" SHPK, - Prishtinë, të dt. 29.05.2022 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi dhe mirëmbajtja e klimave ne objektin e komunës dhe institucioneve tjera Komunale", me Nr. të Prok: : 616-22-1994-1-2-1 dhe numër te brendshëm 616 22 019 121, kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK kontrate te AK –së, të datës 24/05/2022.

1. Vërtetohet Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues i datës 24/05/2022.
2. Autoriteti Kontraktues, vendos që te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit per tenderin "Furnizimi dhe mirëmbajtja e klimave ne objektin e komunës dhe institucioneve tjera Komunale", me Nr. të Prok: 616-22-1994-1-2-1 dhe numër te brendshëm 616 22 019 121, sipas Njoftimit mbi Vendimin e AK te publikuar me datën: 24/05/2022.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

OE "As tech" SHPK, - Prishtinë me datë 29.05.2022, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi dhe mirëmbajtja e klimave ne objektin e komunës dhe institucioneve tjera Komunale", me Nr. të Prok: 616-22-1994-1-2-1 dhe numër te brendshëm 616 22 019 121.

Autoriteti Kontraktues, me datë 01.06.2022, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë

Autoriteti Kontraktues, ka bere vleresimin e ofertave gjithnje duke u mbeshtetur ne LPP dhe ne RRUOPP, duke respektuar Parimet e Pergjithshme te LPP, nenin 6 Ekomiciteti dhe Efikasiteti dhe nenin 7 Barazia ne trajtim dhe jo diskriminimi.

Pretendimet lidhur me ate se OE i propozuar per kontrate ka ofruar çmime ab normalishte te uleta, ky pretendim nuk qendron. Pretendimi se Autoriteti Kontraktues ka bere kerkese per sqarime vetem per nje pozicion por jo edhe per pozicionet tjera, AK ju sqaron se AK ka kerkuar sqarime per pozicionin i cili ka pasur dallim te madh nga çmimi i dhene i OE te propozuar per kontrate dhe çmimi i dhene i OE te dyte me radhe. OE i propozuar per kontrate perpos qe ka dhene sqarime bindese per AK po ashtu ka deklaruar se po qe se AK kerkon, eshte i gatshem ta beje sigurimin e egzekutimit deri ne 20 % te vleres se ofertes.

AK gjate vleresimit te ofertave po ashtu eshte bazuar edhe ne vendimin e OSHP-se si ne vazhdim :

Baza Ligjore:

Rregullat e Udhëzuesit Operativ për Prokurimit Publik – RRUOPP – neni 42:
Referoju rregullave të aprovuara nga KRPP, të publikuara në web-faqen e KRPP-së, B57 “Rregullat për tenderët jo-normalisht të ulët”.

Vendimi i OSHP-së nr. 590/19 - 13.11.2019.

Procedura e poentimit të çmimit është një procedurë e cila përdoret në prokurimin publik për rastet kur autoriteti kontraktues “nuk e di” sasinë e artikujve që do të porosisë, dhe për këtë qëllim secili artikull në listë të çmimeve e ka sasinë “1”. Gjatë zbatimit të kontratës porositë bëhen varësisht prej nevojave që dalin. Lista e çmimeve ndahet në disa kategori dhe secilës prej tyre iu jepet një peshë e caktuar në totalin prej 100%. Poentimi i çmimeve shërben vetëm për të vlerësuar ofertat, ndërsa kontrata zbatohet me çmimet për njësi. Për këta tenderë nuk mund të aplikohet formula për përlogaritjen e çmimit jonormalisht të ulët, pasi çmimi është i poentuar.

Pra tek kriteri çmimi më i ulët me poentim Autoritetet Kontraktuese nuk mund të krahasojnë çmimet e njërit ofertues me çmimet e ofertuesit tjerë pasi që kriteri i tillë kërkon që çmimet e poentuara të bazohen në çmimin e ofertuar dhe jo duke i krahasuar me çmimet e ofertuesve tjerë, sepse në rastet kur kemi krahasimin e çmimeve të ofertave të ndryshme me njëra-tjetrën atëherë kemi të bëjmë me kriterin çmimi më i ulët ku edhe gjenë zbatim Rregulla për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët apo kur përcaktojmë kriterin ekonomikisht më të favorshëm ku varësisht nga pikët maksimale përcaktohet fituesi, pra tek kriteri tenderi me çmimin më të ulët të


poentuar për kontratë rekomandohet OE i cili ofron çmim më të ulët të poentuar pavarësisht çmimit të ofertës për njësi sepse kemi të bëjmë me kontratë kornizë ku nuk kemi sasi indikative.

Shihet qartë se si rezultat i praktikës gjyqësore nga Organi Shqyrtues i Prokurimit në shumë vendime e sidomos në vendimin me nr.590/19 thekson qartazi që tek çmimi më i ulët i poentuar nuk mund të bëjmë krahasime çmimet e njërit ofertues me çmimet e ofertuesit tjerë pasi që kriteri i tillë kërkon që çmimet e poentuara të bazohen në çmimin e ofertuar dhe jo duke i krahasuar me çmimet e ofertuesve tjerë.

Andaj në bazë të asaj se çka është cekur në arsyetim, Autoriteti Kontraktues ka vendosur si në dispozitivin e lartcekur.

Iu dorëzohet:

*Departamentit të Prokurimit
Palës përmes sistemit elektronik – E-Prokurimi
Arkivit*



Zyrtari përgjegjës i Prokurimit